



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/A/142/2012
29/02/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën prej dyqind e njëzet e shtatë (227) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë;*
- (2) Në secilën prej nëntëdhjetë e pesë (95) kërkesave të identifikuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet; dhe*
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët B dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e shtatë nga 27 deri 29 shkurt 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 3342 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e shtatë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Gjithsej 37 kërkesa kontestuese për pronë bujqësore të cila iu paraqitën Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive iu kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e 24 kërkesave për pronë bujqësore në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi tri kërkesa të cilat ishin pezulluar më parë për mbajtjen e seancës dëgjimore. të mëtejme. Gjithsej 3284 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 322 kërkesat e identifikuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 2965 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në vendimet e tjera, pikërisht vendimin KPCC/D/A/140/2012 dhe KPCC/D/A/141/2012.

9. Gjithsej 276 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndonëse 46 kërkesa të identifikuar në kolonën përkatëse të pjesës A dhe C të listës së bashkangjitur ishin subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm për këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive ose gabimeve të tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar atë për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësi i kërkesës si dhe autoritetet kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksat e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

11. Të 90 kërkesat e shënuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse i është dorëzuar një kopje e kërkesës të parashtruar nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dorëzuar një kopje e dokumenteve të parashtruara nga palët respektive përgjegjëse në kërkesë. Të dy palëve, në secilën rast, u është dhënë mundësia të komentojnë për informacionin e ofruar nga pala tjetër, edhe komentet apo informacioni i tillë është marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes të kërkesës.

12. 232 kërkesat e shënuara në pjesën C dhe D të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë

13. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

14. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

15. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

17. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. *Humbje e posedimit jo për shkak të konfliktit.*

18. Në kërkesat nr. 11533 dhe 14615, paraqitësit e kërkesave të cilët janë bashkëpronarë të 1/3 pjesë ideale të pronës së kërkuar, kanë depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësve të pretenduar të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse parashtron se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2001 me marrëveshje gojore nga Kadri Uke Ymeri, i cili e kishte blerë atë nga Vahid Kabashi. Gjykata Komunale në Prizren ka lëshuar aktgjykim më 20 prill 1998 duke u njohur te drejtat pronësore paraqitësve të kërkesave (secilit me 1/3 e pjesës ideale të pronës së kërkuar) dhe e ka detyruar palën përgjegjëse t'u ktheje paraqitësve të kërkesës posedimin e pronës së kërkuar. Më 13 prill 2006, Gjykata Komunale e Prizrenit lëshoi një vendim ku ka pranuar kërkesën e paraqitësve të kërkesës për tërheqjen e kërkesës së tyre për dëbim, pasi paraqitësit e kërkesës donin të paraqisnin një kërkesë të re pasi prona e kërkuar ishte uzurpuar dhe ishin ndërtuar tri shtëpi në të. Në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i komisionit përjashtohet në lidhje me kërkesën, nëse ka filluar procedimi gjyqësor para datës 16 tetor 2006, date në të cilën ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Pasi procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar nga paraqitësit e kërkesës më 1998, atëherë kërkesat nuk janë në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

19. Kërkesat. 20186 dhe 20187 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pranon se pronat e kërkuara ishin të uzurpuar para se ajo të largohej nga Kosova në qershor 1999. Palët përgjegjëse që

aktualisht kanë uzurpuar pronat e kërkuara, pretendojnë se janë pronarë të pronave. Në kërkesën nr. 20186, pala përgjegjëse pretendon se e ka përdorur pronën që nga viti 1986 dhe ka paraqitur procesverbalin e datës 20 tetor 1986 në lidhje me shpronësimin e tokës në vitin 1963, i cili tregon se prona e kërkuar i ishte dhënë atij si kompensim për shpronësimin. Në kërkesën nr. 20187, pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1997 nga paraqitësi i kërkesës dhe familja e saj. Pala përgjegjëse paraqiti një kontratë blerje të panëshkruar. Në kërkesën e dytë, u kontaktua vëllai i paraqitësit të kërkesës i cili është trashëgimtar i pronës së kërkuar dhe ai konfirmoi se pala përgjegjëse e kishte pronën në shfrytëzim prej 20 vitesh dhe shitja e pronës së kërkuar nuk ishte përfunduar pasi çmimi i blerjes nuk ishte paguar tërësisht. Në këto rrethana, humbja e posedimit për pronat e kërkuara nga paraqitësi i kërkesës nuk mund të thuhet së përfshin rrethana që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesat bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

20. Kërkesat nr. 28304, 28308, 28312 dhe 90111 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Ai ka paraqitur një vendim trashëgimie nr. 78/98 datë 11 gusht 2009, ku ai deklarohej si trashëgimtar i vetëm i pronës së babait të tij. Pala përgjegjëse, i cili ka uzurpuar pronat e kërkuar pretendon se babai i tij i ka blerë pronat e kërkuara nga mbajtësi i së drejtës pronësore më 4 maj 1979 dhe se familja e tij ka qenë në posedim të pronave që nga viti 1979. Me tej, pala përgjegjëse thotë se kontrata e blerjes nuk ka qenë e vërtetuar dhe është djegur gjatë luftës, por transaksioni është konfirmuar nga dy dëshmitarë. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive më 6 janar 2012, paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai nuk di nëse babai i tij e ka shitur pronën dhe ai nuk mund të konfirmojë transaksionin pasi nëna, motrat dhe vëllezërit e tij të gjithë kanë vdekur. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se është larguar nga Kosova në vitin 1970 dhe pranoi se edhe pse babai i tij jetoi në Pejë deri sa vdiq në vitin 1989, ai ndoshta i ka shfrytëzuar pronat e kërkuara deri në fillim të viteve 1980, pasi ai ishte i sëmurë. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se as ai dhe as familja e tij nuk i kanë shfrytëzuar pronat e kërkuara në vitet para 1998-1999. Pasi nuk ka dëshmi të humbjes së posedimit apo pamundësi për ushtrimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara që ndërlidhet me konfliktin, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

21. Kërkesat nr 34703, 34704 dhe 34705 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij të ndjerë. E drejta pronësore për pronat e kërkuara i është kthyer mbajtësit të së drejtës pronësore me anë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës nr. P. 779/94 datë 3 mars 1998, për shkak se kontrata e blerjes nr. 2754/65 datë 24 dhjetor 1965 midis bartësit të së drejtës pronësore dhe KBI Kosmet Export në Prishtinë, u deklarua e pavlefshme. Paraqitësi i kërkesës pranon se pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit trashëgimtarët e mbajtësit të së drejtës pronësore nuk kanë mundur të bien dakord midis tyre për pjesët e pronave të kërkuara dhe për rrjedhojë nuk kanë mundur t'i shfrytëzojnë pronat. Në këto rrethana mund të arrihet në përfundimin se kërkesa e paraqitësit të kërkesës ka lindur për shkak të kontestit familjar dhe jo për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit e duhet të hidhen poshtë.

22. Kërkesa nr. 44506 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore ku kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar me një sipërfaqe të pretenduar prej 5 ari. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht ka uzurpuar pronat, pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga një palë e tretë, Dragan Stojana Kujuncic, dhe paraqiti kontratën e vërtetuar të blerjes të vitit 2007 për shitjen e

pronës së kërkuar me sipërfaqe prej 2.5 ari. Kur u ballafaqua me përgjigjen e palës përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës fillimisht konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur dhe e tërhoqi kërkesën, por më pas e korrigjoi atë dhe tërhoqi vetëm një pjesë të kërkesës së saj dhe duke kërkuar gjysmën e mbetur (2,5 ari) nga 5 ari të pretenduara të pronës së kërkuar. Megjithatë, nuk ka dëshmi para Komisionit se parcela e kërkuar ka një sipërfaqe më të madhe se prej 2,5 ari. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

23. Kërkesat nr. 54474, 54477, 54481, 54486, 54491, 54492, 54499 dhe 54508 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësve të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht prindërve të tij. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive për informacion shtesë në lidhje me datën e humbjes së posedimit të pronave të kërkuara, paraqitësi i kërkesës pranoi se nuk e kishte humbur posedimin e pronave të kërkuara si rezultat i konfliktit të vitit 1998-1999, por në vitin 1995, kur familja e tij u largua nga Kosova për në Arandjelovac në Serbi. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ndonëse situata në Kosovë në atë kohë nuk ishte e mirë, ndaj tij e familjes së tij nuk është ushtruar trysni për largim. Kështu kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

24. Kërkesat nr. 91825, 91826, 91827, 91828, 91829, 91830, 91831, 91832, 91833, 91834, 91835, 91836, 91837, 91838, 91839, 91840, 91841, 91842, 91843, 91844, 91845, 91846, 91847, 91848, 91849 dhe 91850 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar, pikërisht bashkëshortes së tij. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar, parcelës nr 2723/1. Ej 28 palë përgjegjëse në këto kërkesa. Palët përgjegjëse kanë ndërtuar gjithsej 32 shtëpi në vitet 1970 dhe kërkojnë të drejtë ligjore për secilën pjesë respektive të pronës së kërkuar që secili prej tyre shfrytëzon, duke pohuar se e kanë blerë tokën e pronës së kërkuar në vitet 1970 nga një pale e tretë ose u është dhënë e drejta e përhershme e shfrytëzimit nga Sekretariati për Urbanizëm i Sekretariatit për Çështje Komunale dhe Banesore të Komunës së Gjilanit. Pjesa më e madhe e palëve përgjegjëse janë palë në kërkesën në Gjykatën Komunale të Gjilanit C No. 220/2010, në të cilën ata kërkojnë njohjen e të drejtave pronësore për copat e tokës në pronën e kërkuar. Ky rast është në pritje për t'u gjykuar në gjykatë. Kur Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës më 6 tetor 2011 dhe 7 dhjetor 2011, ai konfirmoi se mbajtësi i së drejtës pronësore ishte larguar nga prona e kërkuar në vitin 1968 pas vdekjes së babait të tij, kur nena e tij u martua përsëri. Ata kanë banuar në Koretiste nga 1968 deri më 17 qershor 1999, pas së cilës ata u vendosën në Bujanovc në Serbi dhe nuk u kthyen në pronën e kërkuar dhe as nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për rikthimin e të drejtave pronësore për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës paraqiti dy vendime të lëshuara nga Sekretariati i Gjeodezisë dhe Pronave në Komunën e Gjilanit, njëri si kompensim për pjesën e dhënë të tokës nga parcela 2723 dhe një për kompensimin e drithërave dhe drurëve frutorë të shkatërruar në parcelat 2723/1 dhe 2722, i cili tregon se parcela është shpronësuar. Megjithatë, këto dokumente nuk u verifikuan për shkak të mungesës së regjistrave në arkiva. Mbajtësi i së drejtës pronësore, më pas ia ka shitur pronat e kërkuara Isuf Idrizit në vitin 2011. Kontrata përkatëse e blerjes është vërtetuar dhe Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme e cila e tregon blerësin si pronar si pronar të 1/1 pjesë ideale të pronës së kërkuar është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Në këto rrethana nuk mund të konsiderohet se e humbja e posedimit nga ana e paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar ka qenë si rezultat i rrethanave të lidhura drejtpërdrejtë ose që kanë rezultuar nga konflikti i vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit edhe duhet të hidhet poshtë.

25. Kërkesa nr. 48777 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse i cili aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar pretendon se ai e ka blerë pronën e kërkuar nga mbajtësi i së drejtës pronësore. Në mbështetje të pohimit të tij ka paraqitur kontratën e blerjes të vitit 1997 e vërtetuar në gjykatë në vitin 2002. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më parë dy kërkesa në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore me numër DS305604 dhe DS305610 për dy shtëpi të ndodhura në pronën e kërkuar. Këto kërkesa më pas u hodhën poshtë nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore mbi bazën se prona e kërkuar i ishte shitur palës përgjegjëse. Kontesti për pronën e kërkuar u paraqit para Gjykatës Komunale në Viti në vitin 2004 e cila nxori aktgjykimin C. nr. 61/2004, më 10 mars 2006, në dobi të palës përgjegjëse ku konfirmonte të drejtat e tij pronësore për pronën e kërkuar. Aktgjykimi ka hyrë në fuqi më 30 mars 2006. Në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet në lidhje me kërkesën nëse ka filluar procedimi gjyqësor para datës 16 tetor 2006, date në të cilën ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Pasi procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar nga palët më 2004, atëherë kërkesa është në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

26. Kërkesat nr. 22363, 22366 dhe 22368 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Të dy palët përgjegjëse të cilët aktualisht kanë uzurpuar pronat e kërkuara, pretendojnë se i kanë blerë pronat e kërkuara para konfliktit dhe kanë qenë në posedim të tyre para konfliktit. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua dy here nga Sekretaria Ekzekutive ku konfirmoi se ai ishte larguar nga Kosova me familjen e tij në vitin 1963 dhe qysh atëherë ka jetuar në Kraljevë në Serbi. Ai pranoi se disa nga pronat e kërkuara ishin shitur por nuk mundi të japë informacion se cilat parcela ishin shitur dhe kujt i ishin shitur. Ai pranoi gjithashtu se pala përgjegjëse ka qenë në posedim të pronës para konfliktit. Pasi nuk ka dëshmi të humbjes së posedimit apo pamundësi për ushtrimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara që ndërlidhet me konfliktin, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

27. Kërkesat nr. 37583, 38935, 38936 dhe 38937 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Pasi u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive më 5 tetor 2010 dhe u pyet për datën e humbjes së posedimit, paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai e familja e tij kurrë nuk e kishin humbur posedimin për pronat e kërkuara dhe nuk ishin zhvendosur. Ai shpjegoi se ata ishin vendosur në Jagodina në Serbi në vitin 1999, ku kanë një shtëpi edhe jetojnë edhe sot. Babai i tij i ka shfrytëzuar pronat derisa vdiq në vitin 2003 dhe pronat nuk janë shfrytëzuar qysh atëherë. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai thjesht kërkon të konfirmojë të drejtën pronësore. Rrjedhimisht, në mungesë të humbjes së posedimit për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

28. Kërkesat nr. 38129 dhe 38133 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Pasi u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive më 10 dhjetor 2008 për sqarimin e rrethanave të humbjes së posedimit, paraqitësi i kërkesës deklaroi se nuk e kishin humbur posedimin e pronave të kërkuara asnjëherë dhe ato janë të pazurpuara. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se ishte vendosur në Trstenik në Serbi në vitin 1977, ku banon edhe sot e kësaj dite, madje ai vjen shpesh të vizitojë vëllezërit e tij në Kosovë. Rrjedhimisht, në mungesë të humbjes së posedimit për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

29. Kërkesat nr. 35542, 35545, 35547, 35548, 35549, 35550, 35551, 35552, 35553, 35554, 35555, 35556, 35557, 35558, 35560, 35562, 35563, 35564 dhe 35566 janë depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës i cili është djali i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pasi pronat e kërkuara janë në Komunën e Zubin Potokut, zonë më shumicë serbe, paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive për të përcaktuar se si dhe kur kanë humbur posedimin e pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se ai u largua nga Kosova në vitin 1963 dhe se nëna e tij, mbajtëse e pretenduar e së drejtës pronësore, u largua në vitin 1971. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se ai nuk ka qenë i ndaluar për shfrytëzimin e pronës së tij, kërkon thjesht për te trajtuar çështjen e ndërmarrjes në pronësi shoqërore Iber Lepenci që ka uzurpuar pronat e tij. Në mungesë të dëshmive se paraqitësi ka humbur posedimin ose e ka pasur të pamundur ushtrimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara për shkak të konfliktit të 1998-99, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

30. Kërkesat nr. 31507, 31511, 31515, 31519, 31520, 31523, 31524, 31528, 31530, 31533, 31538, 31545 dhe 90018 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimie nr. 12/88, me anë të të cilit ai trashëgoi pronat e kërkuara nga babai i tij dhe fletën poseduese nr. 10 nga kadastra e zhvendosur e cila i tregon pronat e kërkuara në emrin paraqitësit të kërkesës. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 465, e cila është përditësuar në bazë të kontratës nr. 1346/03, me anë të së cilës parcelat në fletën poseduese i janë transferuar Ndërmarrjes Bujqësore Limani, bazuar në autorizimin që është lëshuar nga paraqitësi i kërkesës për pronarin e Ndërmarrjes Bujqësore Limani, Liman Hasa, ku e autorizon atë të shesë pronat e kërkuara në emër të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti autorizimin e datës 11 qershor 2002 ku autorizonte Liman Hasën të shiste pronat e kërkuara. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive për të sqaruar situatën, paraqitësi i kërkesës fillimisht e mohoi se kishte lëshuar autorizim, megjithatë, më pas ai deklaroi se Liman Hasa kishte abuzuar me autorizimin duke ia transferuar pronat e kërkuara vetes. Komisioni vëren se këtu nuk kemi të bëjmë një çështje kërcënimi ashtu si përcaktohet me nenin 4 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, por një çështje ku pretendohet abuzimi me autorizimin e cila bie në juridiksion të gjykatave vendore. Rrjedhimisht në mungesë të dëshmive për humbjen e posedimit apo pamundësisë për ushtrimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara që ndërlihet me konfliktin, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

2. *Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit.*

31. Në bazë të nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, kërkesat mund të paraqiten nga bartësi i së drejtës pronësore, anëtar i bashkësisë familjare ose nga personi fizik i autorizuar i cili posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga bartësi i së drejtës pronësore apo anëtar i bashkësisë familjare i atij personi. Në raste të jashtëzakonshme kur paraqiten probleme për sigurimin e autorizimit, Sekretaria mund të vërtetojë një dokument alternativ i cili autorizon përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës.

32. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me

ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, këtu nuk përfshihen të afërmit nga lidhja martesore, dajallarët/ xhaxhallarët, tezet/hallat, nipat, mbesat apo kushërinjtë, të cilët duhet të paraqesin autorizimin për përfaqësimin e tyre në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Individët të cilët nuk bien në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare nuk mund të paraqiten si paraqitës të kërkesave por si persona që synojnë të përfaqësojnë paraqitësin e kërkesës.

33. Kërkesa në të cilat personi që depoziton kërkesën nuk është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, nuk mund të konsiderohet kërkesë e plotë në përputhje me nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin. 03/L-079, pasi në kërkesën të tillë nuk është përmbushur kërkesa themelore procedurale, pikërisht autorizimi i mbajtësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të bashkësisë familjare.

34. Kërkesat nr. 14641 dhe 14642 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësve të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht kushërinjtë të tyre. Me pasi ai pranoi se i kishte depozituar kërkesat pasi donte vendim nga KKPBK-ja në mënyrë që të kishte mundësi që të regjistronte pronat e kërkuara në emër të mbajtësve respektive të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës nuk ofroi autorizim nga mbajtësit e së drejtës pronësore dhe u kontaktua disa here nga Sekretaria Ekzekutive ku iu kërkuar të ofronte autorizimet e kërkuara. Paraqitësi i kërkesës nuk paraqiti dokumentet e kërkuara. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak të dështimit të paraqitësit të kërkesës për të paraqitur dëshmi për zotësinë për të depozituar kërkesë në emër të mbajtësve të së drejtës pronësore.

35. Kërkesat nr. 29014, 29015, 29016 dhe 29017 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht xhaxhait/dajës së tij i cili është tani i vdekur. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës disa herë, ku i kërkoj atij të paraqitë autorizim ose dëshmi që tregon se ai është anëtar i bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Kur u kontaktua edhe njëherë nga Sekretaria Ekzekutive më 27 janar 2012, paraqitësi i kërkesës deklaroi se ishte trashëgimtari i vetëm i xhaxhait/dajës së tij. Atij iu kërkuar të ofronte një kopje të vërtetuar të certifikatës së vdekjes të xhaxhait/dajës së tij. Megjithatë, më pas, paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ai nuk ishte trashëgimtari i vetëm i xhaxhait/dajës së tij dhe do të ofronte autorizim nga djali i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës nuk paraqiti dokumentet e kërkuara. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak se paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dëshmi për zotësinë e depozitimit të kërkesës në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore.

36. Kërkesat nr. 37011, 37014, 91257, 91638, 91639 dhe 91646 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht xhaxhait/dajës së tij. Paraqitësi i kërkesës nuk ofroi autorizim nga trashëgimtarët e mundshëm ose anëtarët e bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi atë disa here ku i kërkoj të paraqit autorizim dhe certifikatën e vdekjes së mbajtësit të së drejtës pronësore dhe dokumentet identifikuese të personit që ofron autorizimin për të dëshmuar marrëdhënien me mbajtësin e së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* se prona e kërkuar ishte regjistruar në emër të një mbajtësi të ndryshëm të së drejtës pronësore. Kur u ballafaqua me këtë

informacion, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se një pjesë e tokës ishte shitur por ai nuk e dinte se cila pjesë. Komisioni vëren se këto parcela të tokës ishin shitur në vitet 1990. Paraqitësi i kërkesës nuk ofroi autorizimin e kërkuar. Në këtë rrethana kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak se paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dëshmi për zotësinë e depozitimit të kërkesës në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore.

37. Kërkesat nr. 29190, 29191, 29193, 29194, 29196, 29197, 29199, 29200, 29204, 29205, 29211, 29212, 29214, 29215, 29216, 29217, 29218 dhe 29219 janë depozituar nga anëtar i bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletët poseduese për pronat e kërkuara. Megjithatë, më pas, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletët poseduese të cilat ishte përditësuar me vendimin e gjykatës për ndarjen e pronës përmes së cilit pronat e kërkuara në kërkesat me nr. 29190, 29191, 29193, 29196, 29199, 29200, 29204, 29211, 29212, 29214, 29215, 29216, 29218 dhe 29219 ishin ndarë dhe transferuar në emrat e djemve të mbajtësit të së drejtës pronësore, Vojin Pavlovic dhe Radojko Pavlovic, pikërisht xhaxhallarët/dajat e paraqitësit të kërkesës. Në kërkesat me nr. 29194, 29197, 29205 dhe 29217, fletët poseduese ishin përditësuar në bazë të një shitje për palët e treta. Paraqitësi i kërkesës është kontaktuar disa here edhe i është kërkuar të paraqitë autorizimin nga xhaxhallarët/dajat e tij ose trashëgimtarët e xhaxhallarëve/dajave të tij dhe dokumentet identifikuese të personit që jep autorizimin për të dëshmuar marrëdhënien me mbajtësit e së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi djalë të Radojko Pavlovic, i cili deklaroi se nuk jep pëlqimin që paraqitësi i kërkesës të përfaqësojë babain e tij. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua përsëri nga Sekretaria Ekzekutive më 12 dhjetor 2012 dhe deklaroi se xhaxhallarët /dajat e tij refuzuan t'i japin autorizim dhe se ai do t'i tërhiqte kërkesat dhe se ai dëshiron të procedojë me kërkesat e babait të tij. Këto kërkesa trajtohen në një vendim të veçantë të Komisionit. Pasi paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat, ai u kontaktua përsëri më 24 janar 2012 dhe u njoftua se kërkesat që kishin të bënin me pronat e xhaxhallarëve/dajave të tij do hidhen poshtë. Në lidhje me pronat e kërkuara që u janë shitur palëve të treta, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ato ishin shitur dhe kërkoi që kërkesat të hidhen poshtë.

38. Kërkesat nr. 50330, 50331, 50332, 50333, 50335, 50336, 90331, 90332, 90333, 90335 dhe 90336 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletët poseduese nga kadastra e zhvendosur të cilat e tregojnë mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të 2/3 pjesë ideale të pronave të kërkuara. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* se pronat e kërkuara ishin regjistruar në emër të xhaxhallarëve/dajave të paraqitësit të kërkesës, Tomislav Stojanovic dhe Momcilo Pandic dhe kontaktoi paraqitësin e kërkesës disa here ku i kërkonte atij të ofronte dokumente shtesë për të dëshmuar bashkëpronësinë e babait të tij për pronat e kërkuara. Në mungesë të këtyre dëshmive, atij iu kërkua të paraqitë autorizim nga mbajtësit e së drejtës pronësore ose trashëgimtarëve të anëtarëve të bashkësisë familjare të mbajtësve të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai nuk mund të paraqitë autorizimin e tillë, pasi trashëgimtarët e mbajtësit të së drejtës pronësore nuk e autorizonin atë të vepronte në emër të tyre. Më 27 dhjetor 2011, paraqitësi i kërkesës u kontaktua përsëri dhe u pyet nëse mbajtësi i së drejtës pronësore e kishte humbur posedimin e pronave të kërkuara si rezultat i konfliktit. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se familja e tij u largua në vitin 1970 dhe u vendos në Beograd, Serbi ku jeton ende. Megjithatë i shpjegoi se pronat gjenden në një zonë me shumicë serbe dhe gjithmonë janë shfrytëzuar nga kushërinjtë e tij. Paraqitësi i kërkesës nuk paraqiti autorizim dhe sidoqoftë nuk paraqiti dëshmi për humbjen e posedimit ose pamundësinë e ushtrimit të të drejtave pronësore për pronat e kërkuara për shkak të konfliktit. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.

39. Kërkesat nr. 16457, 16458, 16459, 15460 dhe 16462 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vjehrrit të saj. Paraqitësi i kërkesës, në mbështetje të kërkesës, paraqiti fletën poseduese datë 13 shtator 2002 nga kadastrat e zhvendosura. Megjithatë Sekretaria Ekzekutive e gjeti *ex officio* certifikatën e të drejtave të paluajtshme që i tregonte pronat e kërkuara në emër të kunatës së paraqitësit të kërkesës, e cila ishte përditësuar në bazë të kontratës për përkujdesjen jetësore të datës 14 mars 2003. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës disa here dhe i kërkoi asaj të paraqitë autorizimin e kërkuar nga kunata ose nga ndonjë anëtar i bashkësisë familjare të kunatës së saj. Paraqitësi i kërkesës tregoi se nuk ishte e interesuar për ndjekjen e kërkesës dhe kërkoi që ato të hidhen poshtë, megjithatë, ajo refuzoi të tërheqë kërkesat. Rrjedhimisht kërkesat duhen të hidhen poshtë.

40. Kërkesat nr. 40045, 40046, 40047, 40048, 40049, 40050 dhe 40051 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vjehrrit të saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese për pronat e kërkuar të lëshuar nga kadastra e zhvendosur. Pasi paraqitësi i kërkesës nuk përfshihet në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare, ajo u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkua të paraqitë autorizim të lëshuar nga trashëgimtarët e mbajtësit të së drejtës pronësore dhe dokumente për të dëshmuar marrëdhënien familjare midis mbajtësit të së drejtës pronësore dhe ofruesit të autorizimit. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se do të ofronte autorizim nga kunata e saj dhe ka dështuar të ofrojë një të tillë. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

3. *Tjetërsimi vullnetar ose mundësia për të ushtruar të drejtën pronësore.*

41. Kërkesa nr. 06584 është depozituar fillimisht nga kushëriri i paraqitësit të kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pas ai nuk paraqiti autorizim kur kjo i ishte kërkuar nga Sekretaria Ekzekutive disa herë, mbajtësi i së drejtës pronësore u kontaktua dhe u pyet nëse dëshironte të vazhdonte me kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, ai e pranoi këtë. Mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore paraqiti një vendim trashëgimie T. nr. 266/05 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj dhe kushëriri i tij paraqiti certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme e cila e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 22 329 e cila e tregon pronën e kërkuar në emër të një palë të tretë. Ndryshimet janë bërë në bazë të kontratës së blerjes Vr. Nr. 4560/05 të lidhur midis mbajtësit të së drejtës pronësore dhe palës të tretë. Mbajtësi i së drejtës pronësore u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive më 5 janar 2012 dhe konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur, megjithatë ai refuzoi ta tërheqë kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

42. Kërkesat nr. 07874, 07879, 07882, 07884 dhe 07889 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Djali e paraqitësit të kërkesës me pas e informuan Sekretarin Ekzekutive se paraqitësi i kërkesës kishte vdekur më 30 gusht 2007 dhe se procedura e trashëgimisë kishte filluar. Djali që është deklaruar trashëgimtar ka paraqitur një deklaratë ku deklaroi se ai ishte trashëgimtar dhe se dhjetë parcelat ishin shitur, përfshirë pronat e kërkuara. Pasi u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive a ra dakord për të paraqitur vendimin e trashëgimisë, megjithatë ai dështoi ta bëjë këtë. Ai refuzoi gjithashtu të tërheqë kërkesat pasi kërkon kompensim për shfrytëzimin e pronave të

kërkuara para shitjes. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për këto kërkesa. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

43. Kërkesat nr. 27940, 27948, 27956, 27959, 27963 dhe 27965 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesave të tij paraqiti një fletë poseduese, datë 27 prill 2004. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme e cila i tregon pronat e kërkuara në emër të tri mbajtës të ndryshëm të së drejtës pronësore. Dokumenti është përditësuar në bazë të kontratës së blerjes nr. 241/09 me anë të së cilës pronat e kërkuara ishin shitur nga paraqitësi i kërkesës tek një pale të tretë i cili i ka shitur ato më pas tek mbajtësit aktualë të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës më 27 maj 2009 dhe 14 janar 2011 dhe ai konfirmoi se i kishte shitur pronat e kërkuara. Ai deklaroi se nuk mund ta tërhiqte kërkesën pasi ai jeton aktualisht në Novi Sad në Serbi. Kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

44. Kërkesat nr. 37625 dhe 37626 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Pala përgjegjëse pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara nga mbajtësi i së drejtës pronësore në vitin 2006. Kur u ballafaqua me deklaratën e palës përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës pranoi se pronat e kërkuar ishin shitur dhe dëshiron t'i tërheqë kërkesat, megjithatë dështoi ta bëjë këtë. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

45. Kërkesat nr. 41247, 41249, 41250, 41251, 42282, 42283, 42284, 42285, 42286, 42287, 42288, 42289, 43172, 43173, 43174, 43175, 43176, 43177, 43193, 43194, 43195, 43201, 43202, 43203, 43204, 43205, 43206 dhe 43207 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive i kontaktoi dy djemtë e paraqitësit të kërkesës të cilët informuan se paraqitësi i kërkesës kishte vdekur. Djali i paraqitësit të kërkesës, Radomir Stanisic konfirmoi se babai i tij i kishte shitur pronat e kërkuara pas konfliktit edhe pse nuk ishte i sigurt për kohën. Atij iu kërkua të paraqitë kontratat e blerjes dhe të tërhiqte kërkesat, ai e informoi Sekretarinë Ekzekutive se nuk kishte mundësi të tërhiqte kërkesat pasi jeton Krusevc në Serbi. Kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

46. Kërkesa nr. 44654 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Të tri palët përgjegjëse të cilët e kanë uzurpuar pronën kërkojnë të drejta ligjore dhe dy prej tyre pretendojnë se e kanë blerë pronën e kërkuar nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në vitin 2007 dhe kanë paraqitur kontratat e blerjes dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Kur u ballafaqua me pretendimet e palëve përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se mbajtësi i së drejtës pronësore e kishte shitur pronën tek palët përgjegjëse dhe se ai dëshironte ta tërhiqte kërkesën. Megjithatë ai nuk e tërhoqi kërkesën. Rrjedhimisht, nisur nga fakti se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin mundësinë për të ushtruar të drejtën pronësore për shkak të konfliktit, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

47. Kërkesat nr. 51789, 51790, 51791 dhe 51792 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* aktgjykimin nr. 338/07 datë 16 janar 2008, i cili konfirmon shitjen e pronave të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës dhe një bashkëpronar tjetër tek tri persona të ndryshëm. Certifikatat përkatëse për të drejtat e pronës së paluajtshme janë përditësuar dhe i

reflektojnë këto ndryshime. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe u informua për aktgjykimin, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se i kishte shitur pronat e kërkuara por nuk mund t'i tërhiqte kërkesat për arsye shëndetësore. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

48. Kërkesa nr. 53113 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse i cili aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2000 dhe ka paraqitur kontratën e blerjes dhe fletën poseduese e cila e tregon pronën e kërkuar në emër të tij. Pasi u njoftua me deklaratën e palës përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ai e kishte shitur pronën e kërkuar tek pala përgjegjëse, por refuzon ta tërheqë kërkesën. Komisioni arrin në përfundimin se kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

49. Kërkesa nr. 91705 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të tij. Pala përgjegjëse pretendon se si përfaqësues i autorizuar i mbajtësit të së drejtës pronësore, ia shiti pronën e kërkuar bashkëshortes së tij dhe ka paraqitur kontratën e blerjes nr. 3776/2009 e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës më 27 maj 2009, certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme për pronën e kërkuar dhe një deklaratë të nënshkruar nga mbajtësi i së drejtës pronësore që konfirmon shitjen e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive më 8 dhjetor 2011 dhe 23 janar 2012 dhe konfirmoi shitjen e pronës së kërkuar tek pala përgjegjëse. Megjithatë tregoi se nuk ishte i kënaqur me çmimin që kishte marrë. Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat që përfshijnë rregullimin çmimit të blerjes. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

4. *Res Judicata*

50. Kërkesa nr. 36660 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës kishte paraqitur me herët kërkesën nr. 36663 ku kërkonte konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e së njëjtës prone si në kërkesën nr. 36660. Kërkesa nr. 36663 është miratuar nga Komisioni në tetor 2010. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm më të njëjtin subjekt lëndor përbën *res judicata* dhe rrjedhimisht kërkesa nr. 36660 duhet të hidhet poshtë.

51. Kërkesa nr. 41002 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka paraqitur më parë kërkesën nr. 27064 ku kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e së njëjtës prone si në kërkesën nr. 41002. Kërkesa nr. 27064 është miratuar në gusht 2008. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm më të njëjtin subjekt lëndor përbën *res judicata* dhe rrjedhimisht kërkesa nr. 41002 duhet të hidhet poshtë.

5. *Kërkesat nr. 21251, 21252, 21254, 21259, 21260, 29650, 29651, 29652, 29654, 29655 dhe 29656*

52. Kërkesat nr. 21251, 21252, 21254, 21259, 21260, 29650, 29651, 29652, 29654, 29655 dhe 29656 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Nisur nga një pasaktësi në emrin e mbajtësit të së drejtës pronësore në dokumente të

ndryshme (Petar/Petrus and Pavle/Pave), Komisioni në seancën e 8-të e KKPK-së më 25 gusht 2008 ia ktheu kërkesën Sekretaria Ekzekutive për sqarimin e kësaj çështje.

53. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës më 8 maj 2009 dhe i kërkoi atij të paraqitë dokumente të verifikuara nga zyra e gjendjes civile në lidhje me mospërputhjen e emrit ose të ofronte fletë poseduese të re, të korrigjuar me emrin aktual të mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës i kërkoi Komisionit të ndërpriste përpunimin e kërkesës derisa të përfundonte procedura e trashëgimisë, pasi ai donte të vazhdonte vetëm me kërkesat që lidhen me pronën e tij. Sekretaria Ekzekutive u përpoq disa here të kontaktojë paraqitësin e kërkesës por u informua nga djali dhe e reja se ai ishte vendosur në Moskë në Federatën Ruse. Pavarësisht kërkesave të përsëritura për të ofruar dokumentet e kërkuara që të shpjegonin pasaktësinë në emrat, ai ka dështuar ta bëjë këtë. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.

6. *Kërkesat nr 38117, 38118, 38119, 38120, 38121, 38122, 38123, 38124, 38125, 38126, 38128, 38129, 38130, 38131, 38132, 38134, 38135, 38136, 38137, 38138, 38139, 38140, 38141, 38142 dhe 38143*

54. Kërkesat nr. 38117, 38118, 38119, 38120, 38121, 38122, 38123, 38124, 38125, 38126, 38128, 38130, 38131, 38132, 38134, 38135, 38136, 38137, 38138, 38139, 38140, 38141, 38142 dhe 38143 janë paraqitur nga i njëjti paraqitës i kërkesave në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të të njëjtit mbajtës të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës nuk pretendon për humbje të posedimit për shkak të konfliktit të vitit 1998-99 dhe në të vërtetë i ka konfirmuar Sekretarisë Ekzekutive se ai vazhdon t'i shfrytëzojë pronat e kërkuara. Rrjedhimisht, në mungesë të humbjes së posedimit për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit 1998-99, kërkesat duhet të hidhen poshtë.

55. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion B duhet të hidhen poshtë për mungesë të juridiksionit bazuar në arsyet e lartpërmendura.

C. *Kërkesa të refuzuara*

56. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

57. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat

vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

58. Kërkesa nr. 34694 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës P. nr. 779/94 datë 3 mars 1998, kontrata e blerjes OV nr. 2754/65 datë 24 dhjetor 1965 midis mbajtësit të së drejtës pronësore dhe KBI Kosmet Export në Prishtinë, është deklaruar e pavlershme dhe pronat e kërkuara i janë kthyer mbajtësit të së drejtës pronësore. Pastaj prona e kërkuar u regjistrua në emër të djalit të mbajtësit të së drejtës pronësore, xhaxhait/dajës të paraqitësit të kërkesës, në bazë të kontratës së ndarjes së pronës, ndërkohë që mbajtësi i së drejtës pronësore ishte ende gjallë. Pala përgjegjëse, pikërisht vajza e xhaxhait/dajës të paraqitësit të kërkesës, e trashëgoi pronën me anë të vendimit të trashëgimisë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës dështoi të dëshmoi të drejtën pronësore ose të shfrytëzimit për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë

59. Kërkesat nr. 37113, 37114, 37115, 37117, 37118, 37119 dhe 37120 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Gjatë përpunimit të kërkesës, djali i paraqitësit të kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se paraqitësi i kërkesës kishte vdekur. Djali edhe e reja e paraqitësit të kërkesës e pranuan se pronat e kërkuara i ishin shitur babait të palës përgjegjëse, Rifat Hysenit në vitin 1975, dhe konfirmojnë se familja e palës përgjegjëse kanë qenë në posedim të pashqetësuar që nga shitja në vitin 1975, megjithatë ata të dy pretendojnë se pala përgjegjëse ka dështuar të paguajë çmimin e plotë të blerjes. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës dështoi të dëshmoi të drejtën pronësore ose të shfrytëzimit për pronat e kërkuara para apo në kohën e konfliktit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet. Ky vendim nuk cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës të ndjekë kërkesën për çmimin papaguar të blerjes në gjykatat vendore.

60. Kërkesat nr. 26802, 26803, 26804 dhe 26805 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Gjatë përpunimit të kërkesës, motra e paraqitësit të kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se paraqitësi i kërkesës kishte vdekur. Motra e paraqitësit të kërkesës e pranoi se babai i saj e kishte shitur pronën tek katër vëllezërit e familjes Kutllovci, por nuk ishte e sigurt se cilat parcela ishin shitur në fakt. Megjithatë, ajo konfirmoi se pronat nuk ishin shfrytëzuar nga familja e saj qysh pas shitjes. Me pas ajo deklaroi se numrat e parcelave të shënuara në kontratën e blerjes kishin ndryshuar dhe tani ato përbëhen nga dhjetë numra të rinj parcelash të gjitha të shënuara në emër të familjes Kutllovci, por e mohoi se pronat e kërkuara ishin përfshirë në shitje. Janë konstatuar dy palë të ndryshme përgjegjëse që kanë uzurpuar pronat e kërkuara duke pretenduar që ata i kanë blerë pronat përkatëse. Pala përgjegjëse në kërkesat nr. 26802 dhe 26803 paraqiti kontratë blerje të pavërtetuar që nga viti 1965 dhe një vendim kadastral date 19 qershor 2008 në lidhje me të gjitha prona e kërkuara. Pas kërkesës së Sekretarisë Ekzekutive, Zyra Kadastrale në Fushë Kosovë e informoi Sekretarinë Ekzekutive se parcelat e kërkuara kishin pasur numra të tjera para vitit 1965 por se numrat e parcelave nuk kishin ndryshuar pas vitit 1965. Sekretaria Ekzekutive e gjeti dhe verifikoi certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme që i tregon katër vëllezërit e familjes Kutllovci, secilin si bashkëpronar të pjesës ideale prej $\frac{1}{4}$ të pronave të kërkuara. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës dështoi të dëshmoi të drejtën pronësore ose të shfrytëzimit për pronat e kërkuara para apo në kohën e konfliktit 1998-1999.

61. Kërkesat nr. 47127, 47128, 47129 dhe 47130 janë depozituar nga një përfaqësues i autorizuar në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Me pas, përfaqësuesi i autorizuar konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur tek palët përkatëse përgjegjëse para konfliktit, të cilat kanë marrë menjëherë posedimin e pronave të kërkuara. Pronat e kërkuara janë aktualisht të regjistruara në emrin e palëve përgjegjëse ashtu si u konfirmua nga Sekretaria Ekzekutive në rrjedhën e përpunimit të kërkesave. Përfaqësuesi i autorizuar refuzoi të tërheqë kërkesën pasi ai nuk ishte i sigurt nëse ishte paguar i plotë çmimi i blerjes. Në këto rrethana kërkesa duhet të refuzohet. Ky vendim nuk e cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës të ndjekë kërkesën në gjykatat vendore për çmimin e papaguar të blerjes.

62. Kërkesat nr. 47252 dhe 47253 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Më pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se të dy pronat e kërkuara janë shitur tek pala përgjegjëse në vitin 1972, dhe pala përgjegjëse ka qenë në posedim të pronave të kërkuara që nga shitja. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar se pronat e kërkuara janë tani të regjistruara në emër të palës përgjegjëse. Megjithatë paraqitësi i kërkesës dështoi të tërheqë kërkesat edhe pse tregoi se do ta bënte këtë. Në këto rrethana kërkesa duhet të refuzohet.

63. Kërkesa nr. 10510 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Më pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi se e kishte shkëmbyer pronën e kërkuar me palën përgjegjëse për një parcelë tjetër në vitin 1976 përmes një marrëveshje gojore por transformimi formal nuk është përfunduar asnjëherë. Pala përgjegjëse e konfirmoi transaksionin. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

64. Kërkesat nr. 50129 dhe 50130 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij. Pala përgjegjëse i kontestoi kërkesat duke deklaruar se ai i kishte blerë pronat e kërkuara nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në vitin 1993. Paraqitësi i kërkesës paraqiti dy fatura ku tregohet pagesa për blerjen e pronës së kërkuar, të nënshkruara nga paraqitësi i kërkesës. Më pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi se pronat e kërkuara i ishin shitur palës përgjegjëse dhe u pajtua të tërheqë kërkesën, por dështoi ta bëjë këtë.

65. Kërkesat nr. 24602, 24607 dhe 24613 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij. Më pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ai i kishte shitur pronat e kërkuara tek pala përgjegjëse në vitin 1982 me anë të një transaksioni informal edhe pse i kishte trashëguar pronat e kërkuara nga nëna e tij në vitin 1998 pasi gjykata nuk është informuar për transaksionin informal. Paraqitësi i kërkesës pranon se pala përgjegjëse ka marrë posedimin e pronave të kërkuara në vitin 1983. Paraqitësi i kërkesës u pajtua të tërheqë kërkesën por nuk ka bërë kështu. Komisioni konsideron se, nisur nga transaksioni informal i vitit 1982, paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur mundësi të trashëgojë në mënyrë të vlefshme pronën e kërkuar dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë.

66. Kërkesa nr. 26069 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës dhe babai i tij u kontaktuan nga Sekretaria Ekzekutive dhe të dy konfirmuan se mbajtësi i së drejtës pronësore e kishte shkëmbyer pronën e kërkuar me palën përgjegjëse për një parcelë tjetër në vitin 1979 me një sipërfaqe prej 60 ari. Ata të dy konfirmuan se vëllai i mbajtësit të së drejtës pronësore ia shiti përsëri palës përgjegjëse gjysmën e tij prej 60 ari dhe ata kërkojnë t'u kthehet gjysma tjetër. Në mungesë të

dëshmime se paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore ka të drejtën e pronësisë apo të drejta të tjera pronësore për pronën e kërkuar, kërkesa duhet të refuzohet.

67. Kërkesa nr. 11792 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij. Kërkesa nuk lidhet me konfliktin e vitit 1998-1999, pasi prona e kërkuar është shpronësuar gjyshit të tij nga Komuna e Prizrenit në vitin 1938. Më tej paraqitësi i kërkesës pranoi se ka jetuar në Prizren para dhe pas konfliktit. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

68. Kërkesat nr. 53191, 53193, 53195, 53200 dhe 53201 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Djali i paraqitësit të kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se paraqitësi i kërkesës kishte vdekur pas depozitimit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një dokument që tregon historiatin e parcelës të lëshuar nga Zyra Kadastrale në Deçan më 30 gusht 1995. Dokumenti tregon se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka pasur posedimin e parcelës së kërkuar nga 1932 deri 1948, kur u themeluan kooperativat bujqësore. Megjithatë dokumenti nuk tregon se si mbajtësi i së drejtës pronësore e ka humbur posedimin e pronave të kërkuara pas vitit 1948, ai tregon se në vitin 1955 dhe 1971 pronat janë regjistruar në emër të palëve të treta. Të katër palët përgjegjëse të kërkesave pretendojnë se i kanë blerë pronat e kërkuara dhe paraqitën dëshmi të pronësisë për pronat e kërkuara në formën e fletëve poseduese dhe certifikatave për të drejtat e pronës së paluajtshme. Dëshmitë u konfirmuan nga Sekretaria Ekzekutive në rrjedhën e përpunimit të kërkesave, megjithatë djali i paraqitësit të kërkesës refuzon të pranojë se pronat e kërkuara janë shitur dhe pretendon se ato janë të uzurpuara ilegalisht. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës dështoi të dëshmojë se mbajtësi i së drejtës pronësore ka pasur të drejtë pronësore për pronat e kërkuara menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

69. Kërkesat nr. 54788, 54789 dhe 54790 janë depozituar në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore për pronat e kërkuara. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai i ka shitur pronat e kërkuara tek pala përgjegjëse në vitin 1986, dhe se pala përgjegjëse mori menjëherë posedimin e pronave të kërkuara. Ai pretendon se pala përgjegjëse nuk ia kishte paguar çmimin e plotë, megjithatë kjo u kundërshtua nga pala përgjegjëse. Më pas, bashkëshortja e paraqitësit të kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se paraqitësi i kërkesës kishte vdekur dhe se ajo edhe i biri, të dy ishin vendosur në Kragujevc në vitin 1986/1987. Djali i tij konfirmoi se paraqitësi i kërkesës i kishte shitur pronat e kërkuara tek pala përgjegjëse në vitin 1986, por nuk e dinte se sa ishte shuma e çmimit të blerjes që ishte paguar. Komisioni nuk ka juridiksion për kontestet që kanë të bëjnë me çmimin e blerjes dhe rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të ndjekur kërkesën për çmimin e papaguar në gjykatat vendore.

70. Kërkesat nr. 38523, 38524, 38525 dhe 38526 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht xhaxhait/dajës së tij. Pasi paraqitësi i kërkesës nuk përfshihet në përcaktimin e anëtarit të bashkësisë familjare, paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkuar të paraqitë autorizim të lëshuar nga trashëgimtarët e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai e kishte blerë pronën e kërkuar nga xhaxhai/daja i tij por nuk kishin bërë kontratë blerje, kështu që ndryshimet nuk ishin bërë në kadashtë. Ai deklaroi se trashëgimtarët nuk i jepnin atij autorizim. Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi të pronësisë për pronat e

kërkuara, po ashtu nuk ka paraqitur as edhe autorizim nga trashëgimtarët e mbajtësit të së drejtës pronësore për të ndjekur kërkesën në emër të tyre. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

71. Kërkesat nr. 36842, 36843, 36844, 36845, 36847, 36848, 36849 dhe 36850 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 83 datë 18 janar 2005 dhe Sekretaria Ekzekutive gjeti fletën poseduese nr. 83 datë 13 nëntor 2007 të dyja të regjistruara në emër të katër bashkëpronarëve të ndryshëm. Ndonëse paraqitësi i kërkesës pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara në vitin 1983 ai dështoi të ofrojë dëshmi për transaksionin e pretenduar. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore për pronat e kërkuara para ose gjatë konfliktit në vitin 1998-1999. Kërkesa duhet të refuzohet

72. Kërkesat. 40202, 40203, 40204, 40205, 40206, 40207, 40208, 40209, 40210, 40211, 40212, 40213, 40214, 40215 dhe 40216 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 49 datë 3 nëntor 1976 e regjistruar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës dhe kontratën e ndarjes date 12 dhjetor 1976, ku pronësia për pronën duhet të ndahet në mënyrë të barabartë midis paraqitësit të kërkesës dhe motrës së tij pas vdekjes së babait të tyre. Sekretaria Ekzekutive e gjeti fletën poseduese nr. 129 në emër të babait të paraqitësit të kërkesës por parcelat e tokës të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës në fletën poseduese nr. 49 nuk ekzistojnë në fletën poseduese nr. 129. Kështu, paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa herë nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkuar të konfirmojë numrat e saktë të parcelave sipas fletës poseduese të re për secilën kërkesë, pasi fleta poseduese që ai kishte paraqitur nuk ishte mundur të verifikohet. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimie por ai nuk shpjegonte ose sqaronte pretendimet e tij që janë në kundërshtim me fletët e përditësuara poseduese. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua me telefon nga Sekretaria Ekzekutive më 3 shkurt 2012 dhe djali i tij shpjegoi se babai i tij nuk mund të flasë në telefon se është shumë i moshuar dhe me shëndet jo të mirë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose të shfrytëzimit për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999. Kështu kërkesa duhet të refuzohet.

73. Kërkesat nr. 48643, 48644, 48645, 48646, 48647 dhe 48649 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 18, datë 20 gusht 1979 e cila është e regjistruar në emër të një personi të tretë. Dokumenti u verifikua nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio* kur ajo gjeti certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme për pronat e kërkuara të regjistruara në emër të Kadivka Vasic. Paraqitësi i kërkesës paraqiti certifikatën e dhurimit nr. 2329/00 datë 20 maj 2000 me anë të së cilës prona i është transferuar paraqitësit të kërkesës nga Dusan dhe Leposave Milanovic. Megjithatë nuk ka dëshmi të tregojë se si prona e cila është ende e regjistruar në emër të Kadivka Vasic, të jetë transferuar tek Dusan dhe Leposave Milanovic. Sekretaria Ekzekutive nuk mundi të verifikojë pozitivisht kontratën e dhurimit të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa here nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkuar të paraqitë dokumentacion që të dëshmojë pronësinë, por paraqitësi i kërkesës dështoi ta bëjë këtë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999. Kështu kërkesa duhet të refuzohet.

74. Kërkesat nr. 48620, 48621, 48622, 48623, 48624, 48625, 48652, 48653, 48654 dhe 48655 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 43 datë 12 maj 1985, e cila është e regjistruar në emër të Dusan Milanovic dhe një kontratë të vërtetuar e të pretenduar dhurimi nr. 2329/00 datë 20 maj 2000 me anë të së cilës prona i është transferuar paraqitësit të kërkesës nga Dusan dhe Leposave Milanovic. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk mundi ta gjejë fletën poseduese nr. 43 në kadastrë ose fletë poseduese tjetër për pronën e kërkuar. Kontrata e dhurimit nuk u bë e mundur të verifikohet. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive disa here dhe iu kërkua të paraqitë dokumentacion për të dëshmuar pronësinë por ai dështoi ta bëjë këtë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999. Kështu kërkesa duhet të refuzohet.

75. Kërkesat nr. 91046, 91047 dhe 91048 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore pikërisht vjehrrit të saj. Paraqitësi i kërkesës, në mbështetje të kërkesave të saj, paraqiti fletën datë 13 shtator 2002 nga kadastra e zhvendosur. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme e cila i tregon pronat e kërkuara në emër të kunatës së paraqitësit të kërkesës dhe vajzës së mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Kjo certifikatë është përditësuar bazuar në kontratën për përkujdesje jetësore date 13 maj 2003 dhe e cila ka ndërprerë procedure e trashëgimisë. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës disa here dhe e informoi atë për sa më sipër dhe i kërkoi asaj të paraqitë autorizimin e kërkuar nga kunata e saj ose nga një anëtar i bashkësisë familjare të kunatës së saj. Paraqitësi i kërkesës u përpoq të gjejë kunatën por nuk e gjeti atë. Paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive më pas se ajo nuk ishte e interesuar në ndjekjen e kërkesave dhe kërkoi që ato të hidhen poshtë, megjithatë, ajo refuzoi të tërheqë kërkesat. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose të posedimit për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999. Kështu kërkesa duhet të refuzohet.

76. Kërkesa nr. 50449 është depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 138, e cila e tregon pronën e kërkuar në emër të një personi të tretë. Përfaqësuesi i autorizuar i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive disa here dhe iu kërkua të paraqitë dokumentacionin për të drejtat pronësore të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Ai shpjegoi se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore e kishte blerë pronën nga një palë e tretë dhe ky transaksion nuk ishte zbatuar ende dhe premtoi se do të paraqiste kontratën e blerjes por dështoi ta bëjë këtë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose të posedimit për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999. Kërkesa duhet të refuzohet.

77. Kërkesat nr. 54867 dhe 54873 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kontratën e shitjes nr. 763/80 datë 27 nëntor 1980 dhe një vendim të gjykatës për njohjen e të drejtave pronësore nr. 1015/83 datë 8 tetor 1986 e cila e tregon atë si pronar të pronave të kërkuara. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive me pas e gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 180, e cila është përditësuar bazuar në kontratën e shitjes nr. 308/81 datë 22 maj 1981 dhe e regjistruar në emër të një pale të tretë dhe certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 50 datë 12 korrik 2010, e cila ishte e regjistruar gjithashtu në emër të një pale të tretë. Pasi u

kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës pretendoi se pronat e kërkuara ishin të regjistruara në fletën poseduese nr. 144, megjithatë pronat e kërkuara nuk u gjenden në këtë listë. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa herë dhe iu kërkuar të paraqitë dokumentacion shtesë për të dëshmuar të drejtën pronësore për pronat e kërkuara, por pavarësisht garancive të përsëritura se do të vepronte kështu, paraqitësi i kërkesës dështoi ta bëjë këtë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose të posedimit për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999 dhe kërkesat duhet të refuzohen.

78. Kërkesat nr. 28795, 28796, 28799, 28800, 28801, 28802, 28803, 28804 dhe 28805 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një dokument që tregon ndryshimet në regjistrin kadastral nr. 07-952/585 datë 10 tetor 1994 dhe një vendim kadastral nr. 952/495 datë 24 nëntor 1994. Këto dokumente nuk mundën të verifikohen dhe Sekretaria Ekzekutive nuk mundi ta gjejë fletën poseduese të pronave të kërkuara në Departamentin e Kadastrës. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa herë për të paraqitur dokumentacion që të dëshmojë pronësinë për pronat e kërkuara por ai dështoi ta bëjë atë. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose të posedimit për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit në vitin 1998-1999. Kështu kërkesa duhet të refuzohet.

79. Në kërkesat nr. 28522, 91209 dhe 91210 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese datë 23 shtator 2005 e cila e tregon babain e saj si pronarin e pronave të kërkuara. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht ka uzurpuar pronat e kërkuara pretendon se vëllai i tij Shaban Dinaj e ka blerë pronën e kërkuar në kërkesën nr. 28522 nga vëllai i paraqitësit të kërkesës në vitin 1975, dhe pronat e kërkuara në kërkesat me nr. 91209 dhe 91210 në vitin 1983 dhe se i shfrytëzon pronat që nga ajo kohë. Pala përgjegjëse deklaroi se nuk kanë nënshkruar kontratë të blerjes pasi ligji në atë kohë nuk e lejonte shitjen ndëretnike të pronës. Paraqitësi i kërkesës pretendon se prona e babait të saj është ndarë pas vdekjes së tij, 2 ha janë trashëguar nga nëna e saj dhe ajo vetë dhe 2 ha nga dy vëllezërit e saj. Ajo nuk e di nëse prona e vëllezërve të saj është shitur ose jo, megjithatë ajo nuk e ka shitur pronën e saj dhe të nënës së saj dhe e ka shfrytëzuar atë deri në vitin 1998 dhe se nëna e saj ka paguar taksa deri në vitin 1995. Të dy palët paraqitën deklaratatë të dëshmitarëve që konfirmojnë versionet përkatëse të ngjarjeve. Komisioni, gjatë seancës së 25-të më 25 tetor 2011 vendosi të mbahet seancë dëgjimore nga një nga anëtarët e komisionit në bazë të nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 me qëllim që të merret dëshmi verbale e ofruar nga palët. Palët dhe dëshmitarët e ofruar prej tyre u ftuan të merrnin pjesë në seancën dëgjimore të datës 22 nëntor 2011 në zyrat e AKP-së në Prishtinë. Pala përgjegjëse dhe Imer Mujaj dhe Brahim Tigani dëshmitarët e ofruar nga ai, u paraqitën para Komisionit në seancë. Gjatë seancës dëgjimore, të dy dëshmitarët deklaruan se ata e dinin se pala përgjegjëse e bleu pronën nga vëllezërit e paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës u ftua të marrë pjesë në seancë por tregoi se nuk mund të merrte pjesë pasi ishte e sëmure e nuk mund të udhëtonte. Ajo tregoi gjithashtu se ishte e shqetësuar për sigurinë. Kështu pasi paraqitësi i kërkesës banon në Mal të Zi, ajo u mor në pyetje në zyrat e AKP-së në Podgoricë me anë të telekonferencës më 31 janar 2012. Gjatë marrjes në pyetje të paraqitësit të kërkesës ajo deklaroi se nuk e përjashtonte mundësinë që prona të ishte shitur nga vëllezërit e saj por ajo nuk dinte për këtë shitje. Ajo kërkoi që pala përgjegjëse të ofronte dëshmi me shkrim në mbështetje të pretendimeve të tij. Bazuar në dëshmitë para tij, përfshirë dëshmitë e ofruara në seancën dëgjimore, Komisioni konstaton

se pala përgjegjëse i ka blerë në të vërtetë pronat e kërkuara ashtu si pretendonte ai dhe dëshmitarët e tij. Kështu këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

80. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion C , fillimisht paraqitësit e kërkesës pohuan se ata apo familjet e tyre kishin humbur pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999. Megjithatë, më vonë paraqitësit e kërkesës e informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata apo familjet e tyre, sipas rastit, i kanë tjetërsuar pronat vullnetarisht para konfliktit 1998-1999, ose kanë dështuar për të treguar të drejtën pronësore për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit të vitit 1998-99. Kështu, të gjitha këto kërkesa duhet të refuzohen.

D. Kërkesa për kompensim

81. Në kërkesat nr. 11792, 24602, 24607, 24613, 26802, 26803, 26804, 26805, 48643, 48644, 48645, 48646, 48647, 48649, 48620, 48621, 48622, 48623, 48624, 48625, 48652, 48653, 48654, 48655, 54867 dhe 54873 paraqitësit e kërkesave kërkojnë gjithashtu, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin fizik ose humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

E. Vërejtje përmbledhëse.

82. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

83. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA11533	KPA14615	KPA20186	KPA20187	KPA34703	KPA34704	KPA34705
KPA44506	KPA14641	KPA14642	KPA91825	KPA91826	KPA91827	KPA91828
KPA91829	KPA91830	KPA91831	KPA91832	KPA91833	KPA91834	KPA91835
KPA91836	KPA91837	KPA91838	KPA91839	KPA91840	KPA91841	KPA91842
KPA91843	KPA91844	KPA91845	KPA91846	KPA91847	KPA91848	KPA91849
KPA91850	KPA44654	KPA48777	KPA28304	KPA28308	KPA28312	KPA90111
KPA91705	KPA22363	KPA22366	KPA22368	KPA29014	KPA29015	KPA29016
KPA29017	KPA53113	KPA37625	KPA37626			

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA34694	KPA37113	KPA37114	KPA37115	KPA37117	KPA37118	KPA37119
KPA37120	KPA26802	KPA26803	KPA26804	KPA26805	KPA47127	KPA47128
KPA47129	KPA47130	KPA47252	KPA47253	KPA10510	KPA50129	KPA50130
KPA24602	KPA24607	KPA24613	KPA26069	KPA11792	KPA53191	KPA53193
KPA53195	KPA53200	KPA53201	KPA54788	KPA54789	KPA54790	KPA28522
KPA91209	KPA91210					

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA54474	KPA54477	KPA54481	KPA54486	KPA54491	KPA54492	KPA54499
KPA54508	KPA41247	KPA41249	KPA41250	KPA41251	KPA42282	KPA42283
KPA42284	KPA42285	KPA42286	KPA42287	KPA42288	KPA42289	KPA43172
KPA43173	KPA43174	KPA43175	KPA43176	KPA43177	KPA43193	KPA43194
KPA43195	KPA43201	KPA43202	KPA43203	KPA43204	KPA43205	KPA43206
KPA43207	KPA36660	KPA37011	KPA37014	KPA37583	KPA38129	KPA38133
KPA38935	KPA38936	KPA38937	KPA41002	KPA51789	KPA51790	KPA51791
KPA51792	KPA91257	KPA91638	KPA91639	KPA91646	KPA35542	KPA35549
KPA35550	KPA35551	KPA35552	KPA35553	KPA35554	KPA35555	KPA35556
KPA35557	KPA35558	KPA35560	KPA35562	KPA35563	KPA35564	KPA35566
KPA31507	KPA31511	KPA31515	KPA31519	KPA31520	KPA31523	KPA31524
KPA31528	KPA31530	KPA31533	KPA31538	KPA31545	KPA90018	KPA29190
KPA29191	KPA29193	KPA29194	KPA29196	KPA29197	KPA29199	KPA29200
KPA29204	KPA29205	KPA29211	KPA29212	KPA29214	KPA29215	KPA29216
KPA29217	KPA29218	KPA29219	KPA50330	KPA50331	KPA50332	KPA50333
KPA50335	KPA50336	KPA90331	KPA90332	KPA90333	KPA90335	KPA90336
KPA06584	KPA07874	KPA07879	KPA07882	KPA07884	KPA07889	KPA21251
KPA21252	KPA21254	KPA21259	KPA21260	KPA29650	KPA29651	KPA29652
KPA29654	KPA29655	KPA29656	KPA35545	KPA35547	KPA35548	KPA16457
KPA16458	KPA16459	KPA16460	KPA16462	KPA27940	KPA27948	KPA27956
KPA27959	KPA27963	KPA27965	KPA40045	KPA40046	KPA40047	KPA40048

KPA40049	KPA40050	KPA40051	KPA38117	KPA38118	KPA38119	KPA38120
KPA38121	KPA38122	KPA38123	KPA38124	KPA38125	KPA38126	KPA38128
KPA38130	KPA38131	KPA38132	KPA38134	KPA38135	KPA38136	KPA38137
KPA38138	KPA38139	KPA38140	KPA38141	KPA38142	KPA38143	

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA38523	KPA38524	KPA38525	KPA38526	KPA36842	KPA36843	KPA36844
KPA36845	KPA36847	KPA36848	KPA36849	KPA36850	KPA40202	KPA40203
KPA40204	KPA40205	KPA40206	KPA40207	KPA40208	KPA40209	KPA40210
KPA40211	KPA40212	KPA40213	KPA40214	KPA40215	KPA40216	KPA48643
KPA48644	KPA48645	KPA48646	KPA48647	KPA48649	KPA48620	KPA91046
KPA91047	KPA50449	KPA54867	KPA54873	KPA28800	KPA28801	KPA28802
KPA28803	KPA28804	KPA28805	KPA28795	KPA28796	KPA28799	KPA48621
KPA48622	KPA48623	KPA48624	KPA48625	KPA48652	KPA48653	KPA48654
KPA48655	KPA91048					